

Aneksi 1

ANEKSI 1. TABELA E SHPENZIMEVE TË PERLLOGARITURA

Aneksi 1.1 Lista e shpenzimeve të pranueshme te perlllogaritura

a-

(Nëse tatimpaguesi është pagues i TVSH)*

Nr:	Lloji i shpenzimit	Lloji i njësive	Numri i njësive	Çmimi Total për njësi me TVSH (lekë)	TVSH (Lekë)	Çmimi / njësi pa TVSH (Lekë)	Vlera totale (pa TSH) (Lekë)
	Shpenzimet totale te pranueshme te perlllogaritura						
	Kontributi i GIZ në %						
	Kontributi i përfituesit të grantit në %						

*Shënim – mund të shtohen rrjeshta të tjerë

b-Ose (nëse përfituesi nuk është pagues i TVSH)*

Nr:	Lloji i shpenzimit	Lloji i njësive	Numri i njësive	Çmimi për njësi pa TVSH (Lek)	TVSH (Lek)	Çmimi total për njësi me TVSH (Lek)	Vlera totale (me TVSH) (Lek)

	Shpenzimet totale te pranueshme te perlllogaritura						
	Kontributi i GIZ në %						
	Kontributi i përfituesit të grantit në %						

*Shënim – mund të shtohen rrjeshta të tjerë

Aneksi 1.3 Burimet e pritshme të financimit të shpenzimeve totale të perlllogaritura

Kontributet e pritshme	Shuma (Lek)	Përqindja
GIZ		
Kontributi i Përfituesit të Grantit:		
Shpenzimet totale te pranueshme		

Aneksi 2

Përshkrimi i Investimit

1. Marrëveshja e nënshkruar i referohet Investimit të mëposhtëm:

Vlera në seri “.....”

Lloji i investimit:

Titulli i investimit:

Statusi ligjor i Përfituesit të Grantit:

Numri tatimor

Përfaqësuar nga:

Numri ID (për personat fizik):

Adresa zyrtare e plotë:

2. Investimi duhet të përdoret për punët/shërbimet/mallrat e mëposhtëm të treguar në Shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje Granti:

Nr. / KODI	LLOJI I SHPENZIMEVE
*	Mund të shtohen rrjeshta të tjerë

3. Vendndodhja e Investimit është:

- a) Adresa:
- b) Nr. Postar:
- c) Qyteti:
- d) Fshati:
- e) Rajoni:

Aneksi 3

Kushtet e Përgjithshme të zbatueshme për Marrëveshjen e Grantit

PËRMBAJTJA

Neni 1 – Detyrimi për dhënien e informacionit dhe kontrollit në vend

Neni 2 – Konflikti i Interesave

Neni 3 - Konfidencialiteti

Neni 4 - Vizibiliteti

Neni 5 - Të drejtat e pronësisë

Neni 6 – Monitorimi i Investimit

Neni 7 – Mbarimi i Kontratës

Neni 8 – Autorizimi dhe ekzekutimi i pagesës së fundit

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE

NENI 1 – DETYRIMI PËR DHËNIEN E INFORMACIONIT DHE KONTROLLI NË VEND

1.1 Përfituesi i Grantit duhet t'i japë GIZ-së të gjithë informacionin për zbatimin e Investimit.

1.2 GIZ-ja mund të kërkojë të dhëna shtesë në çdo kohë dhe këto të dhëna duhet të jepen brenda 20 ditëve të punës nga kërkesa.

1.3. GIZ-ja ka të drejtën e kryerjes së kontrolleve në vend në çdo kohë dhe fazë të zbatimit të Investimit dhe përsa kohë që kjo Kontratë është në fuqi. GIZ-ja ka të drejtën të kërkojë akses tek të gjitha godinat, ambientet, pajisjet, asetet dhe pronat që lidhen me Investimin. Aksesit duhet t'i jepet edhe Autoriteteve Kombëtare që bëjnë verifikimin e standardeve minimale kombëtare përkatëse të projektit të planifikuar të investimit (veprimet).

1.4 Përfituesi i Grantit ose përfaqësuesit e tij/saj të autorizuar janë të detyruar të identifikojnë veten me kërkesë të personave të autorizuar të GIZ-së gjatë kryerjes së kontrolleve në vend.

NENI 2 – KONFLIKTI I INTERESAVE

2.1 Përfituesi i Grantit merr përsipër të ndërmarrë masat më të nevojshme për evitimin e konfliktit të interesave dhe duhet të informojë GIZ-në pa vonesë për çdo situatë që përbën ose ka të ngjarë të çojë në një konflikt të tillë.

NENI 3 - KONFIDENCIALITETI

3.1 GIZ-ja dhe Përfituesi i Grantit merr përsipër të ruajë konfidencialitetin e të gjitha dokumenteve, informacioneve ose materialeve të tjera që iu komunikohen në konfidencë të paktën 5 vjet pas pagesës së fundit.

NENI 4 – VIZIBILITETI

4.1 Përfituesi i Grantit duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme për të treguar se Investimi po financohet nga Skema "SARED" e Grantit për Mbështetjen ndaj Bujqësisë dhe Zhvillimit Ekonomik Rural për Zonat e Prapambetura në Shqipëri të financuara me fondet e qeverive Daneze dhe Gjermane, siç përshkruhet në Udhezuesin për Aplikantët nëpërmjet një afisheje qartësisht të dukshme dhe/ose një pllakati.

4.2 Afishja dhe/ose pllakati do të prodhohen dhe do t'i jepen përfituesit nga zyrat SARED në rajon.

4.3. Përfituesi i Grantit autorizon GIZ-në dhe MARDWA të publikojnë emrin dhe adresën e tij, kombësinë, qëllimin e grantit, kohëzgjatjen dhe vendndodhjen si dhe shumën maksimale dhe nivelin e financimit të kostove të Investimit. Shmangia nga publikimi i këtij informacioni mund të lejohet nëse do të vinte në rrezik Përfituesin e Grantit ose do të dëmtonte interesat tregtarë të tij.

NENI 5 – TË DREJTAT E PRONËSISË

5.1 Për evitimin e dyshimit, GIZ-ja nuk përfiton asnjë të drejtë pronësie për ndonjë aset të financuar në këtë Kontratë.

NENI 6 – MONITORIMI I INVESTIMIT

6.1 Nëse GIZ-ja kryen kontrolle gjatë ose pas investimit, Përfituesi i Grantit dhe/ose personat e autorizuar do të ofrojnë akses në ambientet, dokumentacionin dhe të dhënat, që do të mbështesin misionin e kontrollit deri në një periudhë 5 vjeçare pas pagesës së shumës së Grantit.

NENI 7 – MBARIMI I KONTRATËS

7.1 Nëse një palë beson se Kontrata nuk mund të ekzekutohet më me efikasitet ose në mënyrë të përshtatshme brenda periudhës së zbatimit të rënë dakord, ajo do të konsultohet me palën tjetër. Nëse nuk arrihet ndonjë marrëveshje për një zgjidhje, secila palë mund ta mbarojë Kontratën me anë të dërgimit të një njoftimi me shkrim prej 2 muajsh, pa iu kërkuar të paguajë kompensim.

7.2 GIZ-ja mund të mbarojë Kontratën, pa paguar asnjë lloj kompensimi:

- a) kur Përfituesi i Grantit dështon në përmbushjen e detyrimeve të tij dhe, pasi i dërgohet njoftim me shkresë që të përmbushë këto detyrime, prapë nuk i përmbush ato ose nuk jep ndonjë shpjegim bindës brenda 20 ditëve pune nga dërgimi i shkresës;
- b) kur Përfituesi i Grantit ndryshon regjistrimin tregtar, përveçse kur hartohet një amendim që regjistron atë fakt;
- c) kur Përfituesi i Grantit bën deklarata false ose të paplota për përfitimin e grantit të përcaktuar në Kontratë ose jep dokumentacion ose informacion që nuk pasqyron realitetin;
- d) kur Përfituesi i Grantit nuk ka përmbushur detyrimet që lidhen me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Udhezuesin për Aplikantët dhe Kërkesën për pagesë.
- e) kur GIZ ka prova për Përfituesin e Grantit ose ndonjë person apo ent të lidhur me të, për gabime, parregullsi të konsiderueshme ose mashtrime në procedurën e dhënies së kontratës ose zbatimin e grantit; kjo zbatohet gjithashtu për ortakët dhe përfaqësuesit e Përfituesit të Grantit.

7.3 Përfituesi i Grantit, që ka bërë deklarata false, gabime të konsiderueshme ose ka kryer parregullsi dhe mashtrim, ose ka shkelur rëndë detyrimet kontraktore, mund të përjashtohet nga të gjitha kontratat e financuara nga GIZ-ja për një maksimum prej 5 vjetësh nga data në të cilën vërtetohet shkelja, siç konfirmohet pas procedurës adversare me Përfituesin e Grantit. Kjo periudhë mund të shtrihet deri në 10 vjet në rast të një shkeljeje të përsëritur brenda 5 vjetësh nga data e përcaktuar më lart.

7.4. Në rast të mbarimit të Kontratës nga GIZ-ja, GIZ-ja mund të refuzojë pagesat pasi të lejojë Përfituesin e Grantit të dërgojë vërejtjet e tij.

7.5. Kjo Marrëveshje do të mbarojë automatikisht (dhe rrjedhimisht çdo detyrim për pagesë me të) nëse GIZ-ja nuk merr Kërkesën për Pagesë në përputhje me Kontratën me të gjithë dokumentacionin dhe informacionin brenda afatit të parashikuar në Nenin 8.1.

NENI 8 – AUTORIZIMI DHE EKZEKUTIMI I PAGESËS SË FUNDIT

8.1 Procedurat për pagesë përcaktohen në Nenin 3 të Marrëveshjes së Grantit dhe i korrespondojnë kushteve më poshtë:

Përfituesi i Grantit duhet të dorëzojë një Kërkesë për Pagesë brenda 15 ditëve të punës pas përfundimit të periudhës së implementimit të Investimit, përveçse kur ka rrethana dhe arsye specifike për vonimin e dorëzimit, të cilat janë të përligjura nga Përfituesi i Grantit në një kërkesë me shkrim të pranuar nga GIZ-ja.

Përfituesi i Grantit duhet të dorëzojë Kërkesën për Pagesë, duke deklaruar çdo shpenzim të kryer në periudhën e implementimit të Veprimit duke treguar për secilën titullin e saj, shumën, dhe dokumentacionin origjinal bashkëngjitur me të. Kërkesa për Pagesë duhet të mbulojë Investimin në tërësi, pavarësisht se cila pjesë e saj financohet nga GIZ-ja.

Granti do t'i paguhet Përfituesit të Grantit nga GIZ-ja me një pagesë.

Kërkesa për Pagesë do të shqyrtohet me të gjithë kontrollet administrative dhe kontrollet në vend brenda 60 ditësh pas marrjes nga GIZ-ja të saj duke përfshirë të gjithë dokumentacionin përkatës. Afati për pagesë do të skadojë në datën në të cilën llogaria e GIZ debitohet.

8.2 Miratimi i Kërkesës për Pagesë nuk nënkupton pranim të rregullsisë, autenticitetit, plotësisë dhe korrektësisë së deklaratave dhe të dhënave që përmban.

GIZ-ja mund të pezullojë afatin për miratim të një Kërkesë për Pagesë duke njoftuar Përfituesin e Grantit se kërkesa për pagesë është e papranueshme, ose sepse shumat në fjalë nuk është maturuar ose sepse nuk është dorëzuar dokumentacioni i duhur mbështetës ose sepse mendon se është e nevojshme kryerja e kontrolleve të tjera, duke përfshirë kontrollet në vend, për tu siguruar se shpenzimi është i përshtatshëm. Pezullimi do të hyjë në fuqi kur njoftimi të dërgohet nga GIZ-ja. Afati për pagesë do të fillojë përsëri në datën në të cilën të regjistrohet një kërkesë për pagesë e formuluar korrektësisht.

8.3 Për evitimin e dyshimit, çdo Kërkesë për Pagesë që nuk është në përputhje me Udhëzuesin për Aplikantët dhe me këtë Marrëveshje do të refuzohet.

8.4 Krahas dhe pa paragjykim ndaj të drejtës së mbarimit të Kontratës në përputhje me Nenin 8, GIZ-ja, me një vendim të arsyetuar siç duhet, nëse Investimi nuk është zbatuar ose është zbatuar dobët, pjesërisht ose me vonesë, e pakëson grantin fillimisht të përcaktuar në përputhje me zbatimin aktual të Investimit sipas kushteve të përcaktuara në Kontratë.

**ANEKSI 4 : OFERTA/T NGA FURNIZUES(IT) E PËRZGJEDHUR ME SPECIFIKIMET
TEKNIKE**

FAKULTATIVE

ANEKSI 5: FLETA E TË DHËNAVE PËR PUNIMET E NDËRTIMIT